

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29, DATË 30.3.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, dhe nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvend, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2025

PËR

**DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29, DATË 30.03.2023, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 8, pas shkronjës d), shtohet shkronja dh), me përmbajtje si më poshtë:

“dh) përjashtimisht nga përcaktimet e shkronjave a), b), c), ç) dhe d) të këtij neni, artistët, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, nuk do të konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 24 muajsh.”

Neni 2

Në nenin 11, pas shkronjës f), shtohet shkronja g), me përmbajtje si më poshtë:

“g) të ardhurat nga sponsorizimet, deri në masën sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja p.”

Neni 3

Në nenin 12, në pikën 1, shkronja ç), në fund të pikës “ii”, shtohen paragrafët, me përmbajtje si më poshtë:

“Ky rregull nuk zbatohet nëse individi i vetëpunësuar, pavarësisht të ardhurave të përfituara sipas përcaktimeve të shkronjës ç), pikat “i” dhe “ii”, vetëdeklaron në Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit, pranë drejtorisë tatimore rajonale ku është i regjistruar, se nuk është në kushtet e të ardhurave nga punësimi. Deklarata e Statusit të të Vetëpunësuarit është sipas modelit në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe dorëzohet në të njëjtën periudhë me Deklaratën e të ardhurave personale nga të ardhurat nga biznesi, brenda muajit mars. Kjo Deklaratë shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore sipas ligjit të procedurave

tatimore, për të përcaktuar nëse individi i vetëpunësuar nuk është në kushtet e shmangies tatimore.”

Neni 4

Në nenin 40, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si më poshtë:

“1/1 Të ardhurat nga sponsorizimet, deri në masën sipas sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja p, nuk konsiderohet të ardhura të tatueshme të korporatës.”

Neni 5

Në nenin 50, në pikën 1, shkronja p), në nënparagrafin “ii”, pas togfjalëshit “... të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës,...” shtohet togfjalëshi “... për veprimtarinë e federatave sportive, si dhe veprimtarinë e sportistëve të cilët kanë fituar tituj për meritë në sport,...”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI